



Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received/Delivery	24.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPIMSHUK	4406/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.708/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbaitëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.708/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Inspektoratit Policor të Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e mbajtur me datë 24.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.708/2023 e datës 05.05.2023, e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ e punësuar në Inspektoratin Policor të Kosovës, më datë 05.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që kategorizimi në klasën profesionale 3, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Inspektoratin Policor të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 16.05.2023, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja është e punësuar në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe se e njëjta sipas Akt Emërimit me numër 01-112-579 të datës 08.04.2019, ushtron pozitën e punës *Arkatare*, në Divizionin për Buxhet dhe Financa. Më tej nga shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesja ka realizuar koeficientin gjashtë (6) të pagës, ndërsa në muajin shkurt 2023 me hyrjen të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në klasën profesional 3.

Në ankesën e parashtruar në Këshill ankuesja pretendon se klasifikimi i saj në klasën profesional 3 është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-196 për Paga në Sektorin Publik, respektivisht Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Inspektoratin Policor të Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë profesionale 1 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.708/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Ardita Haxhnikaj Deme
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërrrohet:

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së